



01 Nr. 601/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Memorandunit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: “Ndërtimi i Stadiumit në fshatin Kabash-Has”, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 5 të Memorandunit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 249.350,00 € (dyqind e katërdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 418/24 datë 09.07.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të bëhet nga kodi buxhetor, nr. 53618.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - FFK-së,
 - Arkivës së Kryetarit.

